



Jam sëmurë

Ku të mjekohem? Si ta di se ku duhet të shkoj?

Listën e institucioneve dhe të profesionistëve të shëndetësisë pranë banesës sime mund ta gjej në <http://annuaire.sante.ameli.fr>



Tek një profesionist i shëndetësisë jashtë spitalit

Për çdo problem shëndetësor, mund të vizitoheni te një mjek "i përgjithshëm" që do t'ju ekzaminojë dhe do t'ju japë recetë për barnat për të cilat keni nevojë. Nëse keni nevojë për ekzaminime ose kurime plotësuese, ai ju orienton drejt një mjeku "specialist" ose te një ndihmësmjek (infirmier, masazhator fizioterapist,...).



Në farmaci

Për të blerë barnat, me ose pa recetë të mjekut ose të spitalit.
Për të kërkuar këshilla.

Barnat me pagesë mund të mbulohen nga sigurimi juaj shëndetësor: shihni faqen 2 për përçapjet që duhen kryer për të bërë kërkesën.



Në spital

Në rast urgjence

Për disa ekzaminime ose konsulta me specialistë, duke lënë takim.



Në struktura ku mjekoheni falas cilado qoftë situata juaj

Për të gjitha mjekimet, në qendrat e kujdesit shëndetësor (PASS)

Për gratë shtatzëna dhe fëmijët nën 6 vjeç: në qendrat e mbrojtjes së nënës dhe fëmijës PMI

Për tuberkulozën: në qendrën e luftës kundër tuberkulozës (CLAT)

Për depistimin e HIV, hepatiteve dhe IST: në CeGIDD

Për marrjen e mjeteve kontraceptive: në qendrën e planifikimit familjar (CPEF)

Për varësitë (nga droga): në CSAPA

Në shoqatat e specializuara.



Në rast urgjence mjekësore, telefonoj në numrin 15 ose 112 që do të më udhëzojë sipas gjendjes sime.

Vini re

Mos-diskriminimi dhe sekreti mjekësor : Profesionistët e shëndetësisë (mjekët, infirmierët, dentistët, etj.) nuk mund të refuzojnë t'ju mjekojnë për shkak të origjinës suaj. Gjithashtu atyre u ndalohet të transmetojnë informacione mbi gjendjen tuaj shëndetësore kujt do personi tjetër, madje as autoriteteve.

Mjeku kurues: për t'u mjekuar dhe rimbursuar më mirë, duhet të zgjidhni një mjek që do të ndjekë vijimin e gjendjes tuaj mjekësore. Diskutoni për këtë gjatë konsultës suaj të parë.

Asnjë ndërhyrje mjekësore dhe asnjë kurim nuk mund të kryhen pa marrë paraprakisht një informacion të plotë dhe pa pëlqimin tuaj.

Si të përfitonit një sigurim shëndetësor që do të mbulojë mjekimin tuaj?

Në Francë, kurimi është me pagesë, por ju mund të përfitonit një sigurim shëndetësor që do të mbulojë një pjesë ose tërësinë e shpenzimeve tuaja shëndetësore, sipas situatës tuaj. Kërkoni informacione dhe formularët pranë arkës fillestare të sigurimeve shëndetësore (CPAM) ose me telefon në 3646 (numër me pagesë) ose nëpërmjet sitit www.ameli.fr dhe www.cmu.fr.

E rëndësishme

- ✓ **Nëse fëmijët tuaj kanë nevojë për mjekim** : pa prituri që t'ju jepet sigurimi juaj shëndetësor, bëni kërkesën në CPAM duke bashkangjitur dokumentet justifikuese dhe faturat e mjekimeve me qëllim që ato t'ju mbulojnë.
- ✓ **Ju duhet të jepni një adresë fikse ose t'i kërkontë me shpejtësi një organizim një adresë** ku mund të merrni postën tuaj nëse jeni pa banesë të qëndrueshme.



Nuk kam leje qëndrimi dhe jam në Francë që prej më pak se 3 muajsh

Duhet t'i paguaj të gjitha mjekimet e mia...

...por mund të kurohem falas:

- ✓ në spital nëse jam shtatzënë ose për mjekime urgjente, për shembull: plagosje ose sëmundje e rëndë, sëmundje ngjitëse (zgjebe, tuberkuloz, etj.), sëmundje kronike (diabet, etj.), nevojë për një trajtim me barna...
- ✓ në një nga qendrat e mjekimeve falas të renditura në faqen 1.



Nuk kam leje qëndrimi dhe jam në Francë që prej më shumë se 3 muajsh

Kërkoni Ndihmën Mjekësore të Shtetit (AME) pranë CPAM-së nga e cila varem

Nëse plotësoj kushtet (të ardhura të pakta dhe provën që jam në Francë që prej 3 muajsh), do të përfitoj një kartë AME që do ta paraqes gjatë mjekimit tim (në spital, te mjeku, për barnat, etj.). Shpenzimet e mia shëndetësore do të më mbulojnë. Nuk kam nevojë të paguaj mjekimin tim, me përjashtim të disa barnave (me pullë portokalli) dhe, për disa mjekë, një pjesë të tarifës së konsultës.

Pyesni për tarifën para se të vizitoheni.

AME është falas dhe e vlefshme për 1 vit.



Jam në Francë për kohësisht (p.sh. : me një vizë turistike)

Unë duhet t'i paguaj të gjitha mjekimet e mia.

Duhet të kem nënshkruar një siguracion privat me pagesë për të përfitur, në disa kushte, mbulimin e shpenzimeve të mia shëndetësore.



Kam leje qëndrimi dhe jam në Francë që prej më shumë se 3 muajsh

Kërkoni përfitim të sigurimit shëndetësor dhe CMU plotësuese pranë CPAM-së sime.

Për përfitim të sigurimit tim shëndetësor, do të marr një dokument të quajtur "attestation de droits" (vërtetim të drejtash), pastaj një kartë të quajtur "carte Vitale" (karta Vitale), që duhet ta paraqes gjatë mjekimit tim për të marrë rimbursimin e një pjesë të shpenzimeve të mia shëndetësore. Pyesni për tarifën para se të vizitoheni.

Për t'u mbuluar plotësisht, unë mund të përfitoj një sigurim plotësues:

- ✓ Nëse plotësoj kushtet e CMU plotësuese (të ardhura të pakta dhe provën që jam në Francë që prej 3 muajsh), vërtetimi im dhe karta ime Vitale do të rinovohen dhe shpenzimet e mia shëndetësore do të mbulojnë plotësisht. S'kam nevojë të paguaj për mjekimin tim. CMU plotësuese është falas dhe e vlefshme për 1 vit.
- ✓ Nëse të ardhurat e mia janë tepër të larta për të përfitur CMU plotësuese, unë mund të marr një "sigurim vullnetar" me pagesë, që do të rimbursojë mjekimin tim sipas kontratës së zgjedhur.

Nëse kam një punë, nëse jam azilkërkues, refugjat, student, anëtar i familjes së një personi që ka tashmë një sigurim shëndetësor : unë mund të përfitoj sigurimin tim shëndetësor **pa prituri 3 muaj duke filluar që nga mbërritja ime në Francë.**

Për kërkesat tuaja të sigurimit shëndetësor në CPAM (një kopje të së cilave tuhet ta mbani):



- ✓ **Përfshini në formularë të gjithë personat që keni në ngarkim dhe që jetojnë në Francë në mënyrë që të përfitojnë edhe ata** .
- ✓ jepni të gjitha provat e pranishme tuaja në Francë me emrin tuaj dhe një datë (për shembull: faturat e qerasë, faturat e telefonit, recetat e një mjeku, vërtetimin e një shoqate ...).
- ✓ Nëse jeni trajtuar ose duhet të trajtoheni, bashkëngjisni faturat e mjekimeve ose raportet mjekësore, me qëllim që dosja juaj e kërkesës të shqyrtohet me përparësi.